



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 184312022
Nr.i iq/Br.str./Nr.pg. 231.11.22
Data/Datum/Date:



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan

Drejtuar: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Dr. Dafina Gexha-Bunjaku, ushtruese e detyrës së ministres
Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrat - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 23 nëntor 2022

Qëllimi i vizitës

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin (në tekstin e mëtejmë: MKP) kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese i Avokatit të Popullit, më 6 korrik 2022 dhe më 13 tetor 2022 e ka vizituar Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan (në tekstin e mëtejmë: QKF).

Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të njeriut të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKP-së të dërguara përmes raportit me rekomandime më 23 dhjetor 2021.¹

Përbërja e grupit monitorues

Ekipi monitorues përbëhej si në vijim:

- Zëvendësi i Avokatit të Popullit
- Këshilltarja juridike për parandalim të torturës
- Këshilltarja-psikologe
- Këshilltarja-punëtore sociale

Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës në QKF, ekipit monitorues të MKP-së, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe personeli mjekësor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e QKF-së.

Ekipi i MKP-së gjatë vizitës u takua me mbikëqyrësen e pavijonit të QKF-së pasi zëvendësdrejtoresha nuk ishte e pranishme. MKP-ja u njoftua nga mbikëqyrësja e pavijonit të QKF-së se momentalisht janë të vendosura gjithsej dyzet e një (41) të burgosura, prej tyre gjashtëmbëdhjetë (16) të dënuara dhe njëzet e një (21) të paraburgosura si dhe katër (4) të burgosura, të cilat janë në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë.

Keqtrajtimi fizik

Ekipi i MKP-së gjatë vizitës në QKF intervistoi një numër të të burgosurave dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për mënyrën se si ato trajtohen nga stafi korrektues. Përkundrazi, disa prej tyre kanë deklaruar shprehimisht se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale.

Kushtet e akomodimit

MKP-ja gjatë vizitës vërejti se qelitë ku akomodohen të burgosurat në QKF kanë ndriçim të mjaftueshmë natyral dhe artificial, si dhe nuk kanë lagështi. Për sa i përket hapësirës për banim për të burgosurat, MKP-ja vërejti se hapësira në dispozicion është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe me standartet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim

¹ MKP, Raport me rekomandime për vizitin në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, publikuar më 23 dhjetor 2021. Për më shumë shih: <https://oik-rks.org/2021/12/24/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-dhe-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

të Torturës (KPT).² Po ashtu MKP-ja gjatë vizitës nuk vërejti mbipopullim në QKF dhe shumica e të burgosurave qenë të vendosura vetëm në dhoma, sipas kërkesave të tyre.

MKP-ja gjatë vizitës mori përsëri ankesa nga të burgosurat për dushet, pasi si pasojë e gjendjes teknike, nga dashi del uji shumë i nxeh të ose shumë i ftoftë dhe të burgosurat detyrohen të gjejnë forma alternative për pastrim.

Lidhur më këtë shqetësim, ekipi i MKP-së bisedoi me mbikëqyrësen e pavijonit, e cila pohoi se dushet kanë probleme teknike, edhe pse vazhdimisht po mundohen t'i rregullojnë e t'i mirëmbajnë. Lidhur më këtë çështje, MKP-ja e Avokatit të Popullit, në raportin e publikuar për QKF-në, më 23 dhjetor 2021, u kishte rekomanduar autoritetevë përgjegjëse, si në vijim “*Të bëhen rregullimet teknike të dusheve në QKF, në mënyrë që të mundë të përdoren në mënyrë adekuate nga të burgosurat.*”³

Po ashtu ekipi i MKP-së, gjatë intervistimit të të burgosurave pranoi shqetësimë se makineritë në lavanderi janë të prishura dhe nuk funksionojnë gati prej tri javësh. Andaj si pasojë e kësaj prishjeje, të burgosurat janë të detyruara të gjejnë forma alternative të pastrimit të rrobave, duke i pastruar rrobat me dorë. Lidhur me këtë problem, ekipi i MKP-së bisedoi menjëherë me udhëheqësen e pavijonit, e cila pohoi se makineritë në lavanderi janë të prishura dhe se janë duke bërë përpjekje për t'i rregulluar.

Ndërsa më 7 korrik 2021, gjatë vizitës ad-hoc në Shtëpinë e Nënave në QKF, MKP-ja kishte takuar të burgosurën M. I., e cila ishte së bashku me fëmijën e saj tetëmuajshe, e akomoduar në këtë shtëpi. Ekipi i MKP-së e kishte intervistuar të paraburgosurën dhe kishte marrë shqetësimin se Shtëpia e Nënave nuk i plotësonte kushtet elementare për qëndrimin e saj dhe të fëmijës, pasi shtëpia kishte inventar të vjetruar dhe të demoluar dhe të papastër. Po ashtu edhe MKP-ja kishte vërejtur se kushtet e akomodimit në Shtëpinë e Nënave në QKF nuk ishin në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe as me standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurave me fëmijë.

Lidhur me këtë çështje, MKP-ja, më 15 korrik 2022, ka kontaktuar përmes shkresës zyrtare me drejtorin e ShKK-së. Në të njëjtë ditë, MKP-ja kishte marrë përgjigje nga drejtori i ShKK-së, me ç' rast ishte informuar se ShKK-ja ishte angazhuar vazhdimisht për rregullimin apo ndërtimin e Shtëpisë së Nënave në QKF. Sipas drejtorit të ShKK-së, në këtë vit u ishte aprovuar projekt “Ndërtimi i shtëpisë për nëna dhe fëmijë në QK Lipjan”, në vlerën prej 60 000 eurosh, por buxheti ishte ndarë për vitin 2023 kur edhe duhet të fillojë së realizuari. Mirëpo deri në realizimin e këtij projekti, sipas drejtorit, ShKK-ja me urgjencë do t'i ndërmerrte veprimet e nevojshme për funksionalizimin dhe rinovimin e Shtëpisë së Nënave. Drejtori ka thënë se ishte siguruar materiali i nevojshëm për rinovimin e shtëpisë dhe se brenda javës do të fillonin punimet.

Ekipi i MKP-së gjatë monitorimit më 13 tetor 2022, përsëri vizitoi Shtëpinë e Nënave dhe vërejti se kjo shtëpi është gëlqerosur dhe pastruar në tërësi. Mirëpo MKP-ja vërejti se inventari në këtë shtëpi është i njëjti, ai i vjetruari, për çka u pajtuan edhe zyrtarët korrektues,

² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

³ MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, publikuar më 23 dhjetor 2021. Për më shumë shih: <https://oik-rks.org/2021/12/24/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-dhe-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

që nuk është ndërruar asnjëherë që nga ndërtimi. MKP-ja vlerëson angazhimin e ShKK-së për gëlqerosjen dhe funksionalizimin e Shtëpisë së Nënave në QKF.

Po ashtu ekipi i MKP-së vizitoi kuzhinën e QKF-së, ku përgatitet ushqimi për tri objektet në Lipjan (për QKF-në, për Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) dhe për Qendrën Edukuese Korrektuese për të Mitur - QEKL). Në kuzhinë janë të angazhuar pesë kuzhinierë, një bukëpjekës dhe tri të burgosura. MKP-ja gjatë vizitës përsëri vërejti se vetëm kuzhinierët kishin uniformë adekuate, ndërsa të burgosurat e angazhuara në kuzhinë nuk kishin uniforma.

Gjatë vizitës, MKP-ja vërejti se kushtet higjenike në kuzhinë ishin në nivelin e duhur dhe kuzhina ishte e pajisur me pajisje të reja të nevojshme për ta kryer punën për përgatitjen e ushqimit. Staf i kuzhinës dhe të burgosurat e angazhuara në punë në kuzhinë ishin të pajisur me libreza sanitare.

Regjimi

MKP-ja gjatë vizitës në QKF, për sa i përket regjimit, u njoftua nga të dënuarat se shumica prej tyre janë të angazhuara në punë në furrë, në kuzhinë, në rrobaqepësi dhe në pastrim, ndërsa gjatë stinës së verës angazhohen në kopshte dhe në serrën e qendrës. Kurse të paraburgosurat janë shumë pak të angazhuara në punë dhe në aktivitete të tjera, pasi angazhimi i tyre është subjekt i lejes së gjykatës kompetente.

Ekipi i MKP-së u njoftua se tani është duke u mbajtur trajnimi për prodhimin e bizhuterive të filigranit, trajnim i mbështetur nga “HELP Kosova”. Në këtë trajnim janë të angazhuara pesë të dënuara. Trajnimi zgjat një vit dhe mbahet nga instruktorë të specializuar të këtij programi. Të dënuarat, në fund të trajnimit pajisen me certifikatë. Po ashtu MKP-ja u njoftua nga të dënuarat se atyre u mundësohet shëtitja jashtë qelisë dy herë në ditë, nga një orë, gjë që është në pajtim me nenin 36 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Mirëpo MKP-ja mori ankesa nga të dënuarat, sidomos nga ato me burgim afatgjatë, të cilat pohuan se numri i aktiviteteve dhe i angazhimeve në QKF nuk është i mjaftueshëm. Avokati i Popullit i ka potencuar ankesat e njëjtë edhe në Raportin me rekomandime për Qendrën Korrektuese për Femra dhe për Qendrën Korrektuese për të Mitur⁴, i cili ishte publikuar më 23 dhjetor 2021 dhe ishte rekomanduar: “*Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të burgosurat (përshirë të paraburgosurat), kur një gjë e tillë është e mundur. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të burgosurve të dënuar me dëname afatgjata.*”

Në këtë drejtim MKP-ja vëren se KPT-ja, në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, në paragrafin 45 të raportit, ndër të tjera u kishte rekomanduar autoritetetë kompetente të Republikës së Kosovës që të ndërmerrnin veprime me prioritet për të ofruar dhe zbatuar një regjim gjithëpërfshirës të aktiviteteve jashtë qelisë për të gjithë të dënuarit (punë, edukim, sport, rekreacion etj.). Më tej në këtë raport theksohej se vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të burgosurve me dëname afatgjata.⁵

Po ashtu të dënuarat pohuan se në QKF nuk posedojnë sallë të fitnesit për realizimin e ushtrimeve fizike, e që u vërejt edhe nga ekipi MKP-së. MKP-ja vëren se neni 36 i LESP-së - marrja me ushtrime fizike, përcakton si në vijim:

⁴ Shih Raportin e publikuar më 23 dhjetor 2021: <https://oik-rks.org/2021/12/24/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-dhe-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>.

⁵ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, publikuar në vitin 2016.

“Personi i dënuar ka të drejtë që të merret me ushtrime fizike aq sa është e nevojshme për ruajtjen e shëndetit të tij dhe të kalojë së paku dy (2) orë në ditë jashtë lokaleve myllura gjatë kohës së lirë. Personi i dënuar mund të merret me ushtrime fizike në ambient të hapur.”⁶

Kujdesi shëndetësor

Gjatë vizitës, MKP-ja vërejti se shërbimi shëndetësor funksionon duke u bazuar në LESP-në dhe në Praktikat Standarde të Veprimit të DShB-së.⁷

Personeli mjekësor i QKF-së përbëhet nga një mjek i rregullt me orar të plotë (08:00-16:00), janë 4 infermierë (4 + kryeinfermierja) të rregullt, psikologu dhe stomatologu po ashtu janë në dispozicion me orar të plotë 8:00-16:00. Ndërsa konsultimet me psikiatrin behën një herë në javë. Po ashtu, gjinekologu ofron shërbime sipas nevojës pa orar të caktuar. Gjatë vitit u bëhet edhe mamografia dhe pap-testi për rastet me indikacione.

Nga dokumentacioni i analizuar, MKP-ja vërejti se në vitin 2022 janë evidentuar: një vetë lëndim, katër lëndime trupore, një tentim vetëvrasje, asnjë lajmërim për abuzime seksuale, dy raste në grevë urie dhe një rast me masë disiplinore të vëtmisë.

Po ashtu, bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant, të sapopranuarit brenda 24 orëve u nënshtrohen kontolleve mjekësore në pajtim me LESP-në dhe me Praktikën Standarde të Veprimit të DShB-së.

Për sa i përket konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKP-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurat dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë këtë parim.

Gjatë vizitës MKP-ja nuk mori ankesa lidhur me kujdesin e ofruar shëndetësor nga njësia shëndetësore në QKF. Shërbimet shëndetësore të cilat nuk mund të ofrohen në QPP, ofrohen në institucionet e tjera publike shëndetësore.

Kontaktet me botën e jashtme

Kontaktet me botën e jashtme mbeten në nivel të kënaqshëm. Në dispozicion të të dënuarave dhe të të paraburgosurave janë vizitat familjare dhe telefonatat, si dhe vikendet për të dënuarat të cilat i plotësojnë kriteret. Po ashtu, për të burgosurat të cilat i kanë familjarët jashtë vendin, u mundësohet kontakti përmes SKYPE-s.

Procedura e parashtrimit të ankesave

Ekipi i MKP-së edhe gjatë kësaj vizite vërejti se në dispozicion të të burgosurave janë kutitë e ankesave, të vendosura nga ShKK-ja, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.

Po ashtu ata mund t’i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit

⁶ Ligji nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

⁷ Praktikat Standarde të Veprimit të Departamentit Shëndetësor në Burgje.

Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/12/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-te-DShB-2019.pdf>

të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre. MKP-ja nuk mori ankesa nga të burgosurat për sa i përket së drejtës për të parashtuar ankesë apo kërkesë.


Andaj, në bazë të të gjeturave gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të burgosurat, përshirë të paraburgosurat, kur një gjë e tillë është e mundur. Vëmendje e veçantë t'u kushtohet të burgosurave të dënuara me dënim afatgjata (*rekomandim i përsëritur*);
- Të burgosurat e angazhuara në punë në kuzhinë, të pajisen me uniforma adekuate (*rekomandim i përsëritur*);
- Të bëhen rregullimet teknike të dusheve në Qendrën Korrektuese për Femra, në mënyrë që të mundë të përdoren në mënyrë adekuate nga të burgosurat (*rekomandim i përsëritur*);
- Shtëpia e Nënave të pajisjet me inventar të ri, përderisa kjo shtëpi është në përdorim;
- Të rregullohen makineritë në lavanderi;
- Të krijohen mundësitë që të akomoduarat në Qendrën Korrektuese për Femra të mundë të merren me aktivitete sportive.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e vprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për vprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi të na informoni për vprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit